

“AD - STAR” sh.p.k

Selia: Rr. Lagjja e Re Përmet
Përmet– Albania

Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(me raportin e audituesit të pavarur në vazhdim)

Tiranë, 23 Mars 2022

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE
SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUHET

Përmbajtja

1. Bilanci Kontabël
2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve gjithëpërfshirëse
3. Pasqyra e flukseve monetare
4. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
5. Shënime

“AD - STAR” sh.p.k

**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUHET

Pasqyra e Pozicionit Financiar e datës 31 Dhjetor 2021

<u>AKTIVET</u>	Shën	31.12.2021	31.12.2020
Aktivët Afatshkurtër			
Aktive monetare	4	164,097,882	136,799,950
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	378,785,692	356,972,419
Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	6	10,428,218	7,507,278
Instrumente të tjera borxhi	7	70,953,297	72,002,831
Totali		460,167,207	436,482,529
Inventari			
Inventar i imët	8	0	0
Produkte të gatshme	8	257,439,373	272,065,841
Totali		257,439,373	272,065,841
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	9	13,766,008	10,806,254
Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)		895,470,470	856,154,573
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale			
Toka	10	88,070	88,070
Ndërtesa	10	120,760	127,116
Makineri dhe pajisje	10	11,007,616	9,378,831
Aktive të tjera afatgjatë materiale (me vl.kontab.)	10	1,077,451	1,158,303
Totali		12,293,897	10,752,320
Totali i aktiveve Afatgjatë (II)		12,293,897	10,752,320
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		907,764,367	866,906,893
<u>DETYRIMET DHE KAPITALI</u>			
DETYRIMET Afatshkurtër			
Huat dhe parapagimet			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	11	153,627,798	116,415,862
Të pagueshme ndaj punonjësve	12	24,258,872	29,230,444
Detyrime tatimore	13	6,829,673	33,942,576
Hua të tjera	14	394,185	394,185
Parapagimet e arkëtuara	15	240,350,238	296,385,470
Totali i detyr. afatshkurtër (I)		425,460,765	476,368,537
DETYRIME AFATGJATA			
Huat afatgjatë			
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare		2,830,768	193,974
Huamarrje të tjera afatgjatë	16	0	6,417,529
Totali I		2,830,768	6,611,503
Provizionet afatgjatë	17	629,354	629,354
Totali i detyr. afatgjatë (II)		3,460,122	7,240,857
Totali i detyrimeve		428,920,887	483,609,394
Kapitali			
Kapitali aksionar	18	40,196,760	40,199,700
Rezerva statusore	18	-	-
Rezerva ligjore	18	1,577,454	1,577,454
Rezerva të tjera	18	297,775,030	139,433,530
Diferenca të parcalizuara kembimi nga konsolidimi		-	-
Fitimet e pashpërndara	18	38,531,581	41,977,655
Fitimi (humbja) e vitit financiar	18	100,762,655	160,109,161
Totali i kapitalit (III)		478,843,480	383,297,500
TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT		907,764,367	866,906,893

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE
SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUHET

Pasqyra e Performancës për periudhën që përfundon më 31.12.2021

	Shënime	Viti 2021	Viti 2020
Shitjet neto	19	1,203,067,847	682,530,612
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	20	2,042,400	2,976,946
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces	20.1	-14,626,468	-31,700,145
Materialet e konsumuara	21	-967,767,657	-357,058,124
Kosto e punës	22	-	-
-Pagat e personelit	22	-59,241,923	-54,102,943
-Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	22	-9,701,842	-8,741,538
Amortizimi dhe zhvlerësimet	10	-2,439,095	-2,664,622
Shpenzime të tjera	23	-28,621,900	-48,110,602
Totali i shpenzimeve		-1,067,772,417	-470,677,829
Fitmi apo humbja nga veprimtaria kryesore		122,711,362	183,129,584
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare:			
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	24	-761,408	-47,260
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	25	-3,089,795	5,429,698
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		-3,851,203	5,382,437
Fitimi (humbja) para tatimit	26	118,860,159	188,512,021
Shpenzimet e tatimit aktual mbi fitimin	26	-18,097,504	-28,402,860
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		100,762,655	160,109,161
Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse			
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM		-	-
Fitimi (Humbje) nga Kursi i këmbimit në konsolidim të degës		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet			
Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën		100,762,655	160,109,161

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

Pasqyrat Financiare “Ad-Star shpk” janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë Më datë 23 Mars 2022

Ekonomisti

Administratori

Robert Xhoxhi



Alfred Çoma



“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE
SHUMAT NE LËKË, PËRNDRYSHE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të flukseve te mjeteve monetare për periudhën që përfundon më
31.12.2021

	Shën	2021	2020
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi pas tatimit	25	<u>100,762,655</u>	<u>160,109,161</u>
<i>Rregullime për shpenzimet jomonetare:</i>			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	<u>2,439,095</u>	<u>2,664,622</u>
		<u>103,201,750</u>	<u>162,773,783</u>
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	5,6,7	-24,192,497	-177,396,180
Rënie/(ritje) në inventarë	8	14,626,468	31,914,436
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	11	37,316,322	14,218,586
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	12	-4,971,572	180,267
Rritje/(rënie) në shpenzimet e shtyra	9	-2,961,063	-1,408,327
Rritje/(rënie) në parapagimet e arketuara	15	-56,035,232	2,287,806
Rritje/(rënie) në detyrimet tatimore	13	-28,809,613	31,394,325
Rritje/(rënie) në Hua dhe Obligacione Afatshkurtra	14	0	-71,916,959
		<u>-65,027,187</u>	<u>-170,726,046</u>
<u>MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u>		<u>38,174,563</u>	<u>-7,952,263</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	10	-5,333,633	-611,354
Arkëtime nga shitja / nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	10	1,352,962	
<u>MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese</u>		<u>-3,980,672</u>	<u>-611,354</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Pagesa e huave		-	4,329,500
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		-2,204,837	-721,517
Dividentë të paguar		-4,841,631	-94,474,180
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
<u>MM neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>		<u>-7,046,468</u>	<u>-90,866,197</u>
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		150,508	282,271
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		<u>27,297,932</u>	<u>-99,147,544</u>
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		<u>136,799,950</u>	<u>235,947,494</u>
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		<u>164,097,882</u>	<u>136,799,950</u>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar për periudhën Janar - Dhjetor 2021

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i Pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	40,197,770	1,577,454	139,433,530	136,227,412	317,436,180
Emetim i kapitalit aksionar					-
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël				160,109,161	160,109,161
Dividentë të Paguar				(94,474,195)	-94,474,195
Rritje e Rezervës së Kapitalit	-		-	-	-
Diferenca të perealizuara nga kurset e këmbimit	1,930			224,424	226,354
Pozicioni më 31 dhjetor 2020	40,197,770	1,577,454	139,433,530	341,520,346	383,297,500
Emetim i kapitalit aksionar					-
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël				100,762,655	100,762,655
Dividentë të Paguar			158,341,500	(163,555,221)	-5,213,721
Rritje e Rezervës së Kapitalit	-			0	-
Diferenca të perealizuara nga kurset e këmbimit	-2,940				-2,940
Pozicioni më 31 dhjetor 2021	40,196,760	1,577,454	297,775,030	139,294,236	478,843,480

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-27

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDON MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHJE SHKRUHET

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria AD - STAR sh.p.k, në vijim e quajtur “Shoqëria”, është themeluar sipas aktit të themelimit më datën 08.05.1994 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datën 09.06.1994. Ad-Star sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali është ndarë në 172 pjesë me vlerën nominale prej 233.000,00 lekë secila. Në datën 05.06.2019 shoqëria ka hapur një degë të saj në Kosovë, Ad-Star shpk Dega në Kosovë, e cila kryen aktivitetin e ndërtimit dhe rikonstruksionit në territorin e Kosovës.

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë me NIPT J69102207W.

Më 31 Dhjetor 2021 shoqëria ka 104 punonjës (31 Dhjetor 2020 131 punonjës). Në datën e këtyre Pasqyrave Financiare struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Emri i ortakut	Numri i pjesëve	% e kapitalit
Alfred Çoma	172	100
Totali	172	100

Aktivitet kryesor i shoqërisë, është: Veprimtari ndërtimore për objekte civile, industriale, bujqësore, ushtarake, banesa, zyra etj për individë vendas dhe të huaj, për ndërtime të ndryshme private e shtetërore, për shtetin, duke organizuar edhe konsultime e veprimtari projektuese, preventivuese, inxhinierike etj.

Administratori ligjor i shoqërisë është z. Alfred Çoma.

Adresa e Shoqërisë është : Rr. Lagjja e Re, Përmet.

Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit, është aktiviteti në Kosovë, si dhe është Rruga Perlat Rexhepi, Pallati UNIKON, Kati 2, Ap nr.9. Tiranë

2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25-2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit 1-14 (SKK) Kontabilitetit të përmirësuar të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 Për shpalljen e detyrueshme të tyre.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten të shprehura në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 25-2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabël kryesore

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të politikave kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa më poshtë:

3.1 Bazat e Konsolidimit

a) Filialet dhe degët

Degët dhe filialet kanë njësitë e kontrolluara nga shoqëria mëmë. Kontrolli ekziston kur shoqëria mëmë ka direkt ose indirekt fuqinë për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme financiare dhe operative të njësisë për të marrë përfitime prej tyre. Shoqëria ka vetëm një degë në Kosovë dhe ka përfshirë në PF të konsoliduar të saj dhe PF individuale të degës nga data e krijimit të saj në vitin 2019.

b) Eliminimi i transaksioneve në konsolidim

Marrëdhëniet brenda grupit si dhe çdo e ardhur apo shpenzim i përealizuar nga marrëdhëniet brenda grupit eliminohen kur përgatiten PF të konsoliduara.

3.2 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

ii) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “Të tjera të ardhura/shpenzime” për diferencat e lidhura me kërkesat për t’u arkëtuar dhe detyrimet ndaj furnitorëve, dhe në zërin “Fitime/humbje nga këmbimi” në rastin e mjeteve monetare.

iii) Operacionet e huaja

Përfshirja në Pasqyrat Financiare të konsolidura të degës të cilat shprehen në monedhë të huaj, është bërë si vijon:

1. Aktivet dhe detyrimet e degës janë vlerësuar me kursin e datës së ndërtimit të Pasqyrave Financiare të shoqërisë mëmë më 31 dhjetor 2021
2. Të ardhurat dhe shpenzimet e degës janë paraqitur në monedhën funksionale të shoqërisë mëmë të përkthyer me kursin mesatar vjetor, kurs i cili bën që vlera në lekë e transaksioneve të jetë afërsisht si kursi i ditës së transaksionit.

3.2 Transaksionet me monedhat e huaja - vazhdim

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2021 janë:

Data /Monedha	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Euro	120.76	123.70
USD	106.54	100.84

Kursi mesatar vjetor i përdorur për përkthimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të degës është 1 Euro = 122.44 lekë. Diferencat e kursit të lindura nga ky përkthim paraqiten direkt në kapitalet e veta si rezerva rivlerësimi në konsolidim, dhe në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, përderisa dega është në kontrollin e mëmës.

3.3 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dorë dhe ato të mbajtura në banka. Në përputhje me SKK 7 “Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare”, Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak).

Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollat e këmbimit, etj). Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.4 Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientat dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka. Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientat e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientat ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer.

Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësise për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlerë të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është e evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

“AD - STAR” sh.p.k

PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË

31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHJE SHKRUHET

3.4 Aktivet financiare - vazhdim

Shoqëria vlerëson cdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient apo debitor dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma. Shuma e zhvlerësimit është diferenca midis vlerës neto kontabël të aktivit dhe vlerës neto aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar, të diskontuara me normën e interesit efektive. Shoqëria nuk ka llogaritur zhvlerësim të klientëve për vitin raportues.

3.5 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 “Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të vogël midis koston (dhe vlerës neto të realizueshme). Kostoja matet me metodën e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

3.6 Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

(ii) Amortizimi

Amortizimi i AAM llogaritet dhe njihet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e vlerës së mbetur me norma të cilat janë të përafërta me jetëgjatësinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit të përdorura në ndërtimin e PF për AAM në kontroll të shoqërisë janë të paraqitura si më poshtë:

	<i>Norma</i>	
	<i>Amortizimit %</i>	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Ndërtesa	5%	Me vlerën e mbetur
Pajisje informatike	25%	Me vlerën e mbetur
Makineri dhe Pajisje	20%	Me vlerën e mbetur

“AD - STAR” sh.p.k

PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHJE SHKRUHET

3.7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes së shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në varësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.8 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtëra dhe afatgjata. Detyrimet afatshkurtëra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe në detyrime të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtëra njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.9 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë aktivitetin kryesor të shoqërisë, neto nga TVSH. Ato njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së produktit/shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri.

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

3.10 Përfitimet e personelit

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi në Shqipëri dhe në Kosovë. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave me ndodhjen e tyre.

3.11

Provizionet

Provizionet njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të bëhet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së detyrimit. Në periudhën raportuese shoqëria nuk ka llogaritur provizione.

3.12

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual mbi fitimin dhe tatimin e shtyrë mbi fitimin. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël.

Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korrigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumën që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve. Për tatimin mbi fitimin për degën në Kosovë ka zbatuar rregullat e kreditimit të tatiimit të huaj.

3.13 Raportimi i segmenteve

Shoqëria bën klasifikimin e segmentave sipas parimit të menaxhimit. Në datën e ndërtimit të PF të konsoliduara ajo ka evidentuar dy segmente raportimi mbi bazën e ndodhjes gjeografike. Informacioni për segmentet gjeografike paraqitet si vijon:

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	Shoqëria mëmë - Shqipëri	Dega në Kosovë	Totali
	Viti 2021	Viti 2021	Viti 2021
Shitjet neto	1,147,039,548	56,028,299	1,203,067,847
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	2,042,400	-	2,042,400
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces	-14,626,468	-	-14,626,468
Materialet e konsumuara	-929,646,085	-38,121,572	-967,767,657
Kosto e punës	-	-	-
-Pagat e personelit	-40,896,004	-18,345,920	-59,241,923
-Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	-9,655,927	-45,915	-9,701,842
Amortizimi dhe zhvlerësimet	-2,439,095	-	-2,439,095
Shpenzime të tjera	-28,122,835	-499,065	-28,621,900
Totali i shpenzimeve	-1,010,759,945	-57,012,472	-1,067,772,417
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore	123,695,535	-984,173	122,711,362
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare:			
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	-761,408	-	-761,408
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	-3,089,795	-	-3,089,795
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	-	-	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare	-3,851,203	-	-3,851,203
Fitimi (humbja) para tatimit	119,844,332	-984,173	118,860,159
Shpenzimet e tatimit aktual mbi fitimin	-18,097,504	-	-18,097,504
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	101,746,828	-984,173	100,762,655
Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse			
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM	-	-	-
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinanciare	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet	101,746,828	-984,173	100,762,655
Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën	101,746,828	-984,173	100,762,655

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHJE SHKRUHET

3.14 Raportimi i segmenteve- Vazhdim

Pasqyra e Pozicionit Financiar	Shoqëria mëmë - Shqipëri	Dega në Kosovë	Totali
	31.12.2021	31.12.2021	31.12.2021
<u>AKTIVET</u>			
Aktivet Afatshkurtëra			
Aktive monetare	152,810,565	11,287,316	164,097,882
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	378,785,692	0	378,785,692
Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	10,428,218	0	10,428,218
Instrumente të tjera borxhi	70,953,297	0	70,953,297
Totali 3	460,167,207	0	460,167,207
Inventari			
Inventar i imët	0	0	0
Produkte të gatshme	257,439,373	0	257,439,373
Totali 4	257,439,373	0	257,439,373
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	13,745,358	20,650	13,766,008
Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)	884,162,504	11,307,966	895,470,470
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale			
Toka	88,070	0	88,070
Ndërtesa	120,760	0	120,760
Makineri dhe pajisje	11,007,616	0	11,007,616
Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	1,077,451	0	1,077,451
Totali 2	12,293,897	0	12,293,897
Totali i aktiveve Afatgjata (II)	12,293,897	0	12,293,897
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)	896,456,401	11,307,966	907,764,367
<u>DETYRIMET DHE KAPITALI</u>			
DETYRIMET Afatshkurtëra			
Huat dhe parapagimet			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	153,108,651	519,147	153,627,798
Të pagueshme ndaj punonjësve	24,258,872	0	24,258,872
Detyrime tatimore	6,186,022	643,651	6,829,673
Hua të tjera	394,185	0	394,185
Parapagimet e arkëtuara	240,350,238	0	240,350,238
Totali i detyr. afatshkurtra (I)	424,297,967	1,162,798	425,460,765
DETYRIME AFATGJATA			
Huat afatgjata			
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare	2,830,768	0	2,830,768
Huamarrje të tjera afatgjata	0	0	0
Totali 1	2,830,768	-	2,830,768
Provizionet afatgjata	629,354	0	629,354
Totali i detyr. afatgjata (II)	3,460,122	0	3,460,122
Totali i detyrimeve	427,758,089	1,162,798	428,920,887
Kapitali			
Kapitali aksionar	40,076,000	120,760	40,196,760
Rezerva statusore	-	-	-
Rezerva ligjore	1,577,454	-	1,577,454
Rezerva të tjera	297,775,030	-	297,775,030
Diferenca të përealizuara nga kurset e këmbimit	-	-	-
Fitimet e pashpërndara	27,523,000	11,008,581	38,531,581
Fitimi (humbja) e vitit financiar	101,746,828	-984,173	100,762,655
Totali i kapitalit (III)	468,698,312	10,145,168	478,843,480
TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT	896,456,401	11,307,966	907,764,367

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë.

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2021 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat. Gjendja e mjeteve monetare dhe të ngjashme në fund të periudhës 2021 paraqitet si vijon:

Përshkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Mjete monetare në bankë	93,098,126	83,747,510
Mjete monetare në arkë	70,999,756	53,052,440
Total	164,097,882	136,799,950

Nga këto mjete monetare 11,287,316 janë mjete monetare pranë degës në Kosovë.

Një paraqitje e shumave të vendosura në institucionet bankare jepet ne vijim:

Mjete Monetare pranë bankave		31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Përshkrimi i Llogarive			
	Vendosje Në lek		
Llogari Rrjedhëse pranë Bankave		15,044,409	58,837,231
Depozita pranë Bankave			
	Vendosje Në Monedhe të huaj		
Llogari Rrjedhëse pranë Bankave		78,053,717	24,910,279
Depozita pranë Bankave			
Total		93,098,126	83,747,510

5. Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve në Shqipëri gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2021. Ato paraqiten me vlerën neto nga zhvlerësimi nga borxhi i keq. Shoqëria nuk ka llogaritur borxh të keq për vitin 2021. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientave jepet në tabelën vijuese:

Përshkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Klientë për shërbime, mallra dhe produkte	378,785,692	356,972,419
Total	378,785,692	356,972,419

Dinamika e të drejtave ndaj klientëve paraqitet si vijon:

Përshkrimi	2021
Gjendja 01 Janar	356,972,419
Rritjet Gjatë periudhës ushtrimore	1,349,218,240
Pakësimet gjatë periudhës ushtrimore	-1,327,404,967
Gjendja 31 Dhjetor	378,785,692

“AD - STAR” sh.p.k

**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHJE SHKRUHET

6. Kërkesa të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë të bilancit paraqiten kërkesat e shoqërisë ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjen e shërbimeve dhe të mallrave. Një paraqitje e detajuar e këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Përshkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Tatim fitim i mbipaguar	7,649,032	-
Debitorë të tjerë	35,548	35,828
Të drejta ndaj shtetit për Sigurime	212,182	212,182
Të tjera Taksa për tu paguar dhe për tu kthyer	133,310	133,310
Garanci të dhëna për punime	2,398,146	7,125,959
Total	10,428,218	7,507,278

7. Instrumenta të tjerë borxhi

Në këtë zë të bilancit paraqiten të drejtat që ka shoqëria ndaj ortakut të saj. Një paraqitje e detajuar e këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	68,515,697	70,765,831
Huadhenie afatshkurtra	2,437,600	1,237,000
Total	70,953,297	72,002,831

8. Inventarët

Shoqëria përdor lloje të ndryshme të inventareve të nevojshëm për aktivitetin e vet. Ajo përdor metodën e inventarizimit periodik për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventarët janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto të realizueshme. Metoda e koston së përdorur është metoda e mesatares së ponderuar. Inventarët paraqiten si vijon:

Përshkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Inventar i imët	-	-
Produkte të gatshme	257,439,373	272,065,841
Total	257,439,373	272,065,841

Në zërin produkte të gatshme paraqiten vlera e apartamenteve të pallateve të ndërtuara nga shoqëria në Shqipëri, të cilat janë të gatshme për tu shitur tek klientët.

9. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Paraqesin shumat e shpenzimeve të kryera nga mëma dhe që do të shpërndahen në periudhat e ardhme, si dhe parapagimet e bëra prej shoqërisë tek të tretët për shërbime që ajo pret ti marrë në periudhat e ardhshme. Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet në tabelën me poshtë:

Përshkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Shpenzime për tu shpërndarë	803,882	938,868
Parapagime për shërbime	12,962,126	9,867,385
Total	13,766,008	10,806,254

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUHET

10. Aktivët Afatgjatë

Gjendja dhe shësat e pakësimit e Aktivëve Afatgjatë Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2021 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e ndryshimit të AAM	Toka, Ndërtime	Instalime, makineri e pajisje	Pajisje zyre e informatike	Të tjera në shfrytëzim (mobiler, pajisje, etj.)	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2019	538,070	20,588,910	4,384,716	-	25,511,695
Blerjet gjatë viti ushtrimor	-	195,899	415,455	-	611,354
Shitjet gjatë viti ushtrimor	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Plusvlera/minusvlera rivlerësimi	-	-	-	-	-
Pakësime/Shësa të tjera	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2020	538,070	20,784,809	4,800,171	-	26,123,050
Blerjet gjatë viti ushtrimor	-	5,106,025	227,608	-	5,333,633
Shitjet gjatë viti ushtrimor	-	-4,483,886	-	-	-4,483,886
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Plusvlera/minusvlera rivlerësimi	-	-	-	-	-
Pakësime/Shësa të tjera	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2021	538,070	21,406,948	5,027,779	-	26,972,797

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka, Ndërtime	Instalime, makineri e pajisje	Pajisje zyre e informatike	Të tjera në shfrytëzim (mobiler, pajisje, etj.)	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2019	316,194	9,081,868	3,308,043	-	12,706,106
Amortizimi i periudhës ushtrimore	6,690	2,324,108	333,824	-	2,664,622
Humbje nga Testi i vlerës gjatë periudhës	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM të shitura	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM të Nxjerrja jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2020	322,884	11,405,976	3,641,867	-	15,370,728
Amortizimi i periudhës ushtrimore	6,356	2,124,278	308,461	-	2,439,095
Humbje nga Testi i vlerës gjatë periudhës	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM të shitura	-	-3,130,924	-	-	-3,130,924
Amortizimi i AAGJM të Nxjerrja jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2021	329,240	10,399,332	3,950,328	-	14,678,901
Vlera neto më 31 Dhjetor 2020	215,186	9,378,832	1,158,304	-	10,752,322
Vlera neto më 31 Dhjetor 2021	208,830	11,007,616	1,077,451	-	12,293,896

Në bilanc Aktivët Afatgjatë të mëmës paraqiten për çdo grup me vlerën neto me amortizimin e akumuluar.

Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura (referoju shënimit 3.5 (ii)), janë në përputhje me kërkesat e SKK 4 për të siguruar një shpërndarje të saktë të kostos së AAM në koston e periudhave që ato përdoren për sigurimin e të ardhurave.

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUE

11. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2021. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Furnitorë brenda vendit	153,627,798	116,415,863
Total	153,627,798	116,415,863

Nga shuma e furnitorëve detyrimet ndaj furnitorëve të degës në Kosovë janë 519,147 lekë.

Dinamika e detyrimeve ndaj furnitorëve paraqitet si vijon:

Gjendja më 01 Janar 2021	116,415,863
Rritjet gjatë periudhës ushtrimore	1,126,520,298
Pakësimet gjatë periudhës ushtrimore	-1,089,308,363
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	153,627,798

12. Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet për pagat e mbetura të papaguara ndaj punonjësve të shoqërisë mëmë. Paraqitja si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Detyrime për paga punonjësit	24,258,872	29,230,444
Total	24,258,872	29,230,444

13. Detyrimet tatimore

Në zë këtë paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore gjendje të papaguara më 31 dhjetor 2021 dhe që janë paguar në vitin 2022. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Detyrimet tatimore

	Shqiperia	Kosova	Total
Pershkrimi	31.12.2021	31.12.2021	31.12.2021
Shteti Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore	946,927	16,303	963,230
Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale	46,246	-	46,246
Detyrim Tatim Fitimi	-	-	-
Tvsh Per tu Paguar	5,192,849	493,546	5,686,395
Tatim ne burim	-	133,802	133,802
Total	6,186,022	643,651	6,829,673

14. Hua të tjera

Në këtë zë paraqiten detyrimet e mëmës. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Dividentë për tu paguar	-	-
Deditor/Kreditor të tjerë	394,184	394,184
Total	394,185	394,185

“AD - STAR” sh.p.k
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË
31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE
SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHJE SHKRUHET

15. Parapagime të Arkëtuara

Në këtë zë paraqiten shumat e arkëtura nga shoqëria mëmë për shërbime që do ti realizojë në periudhat e ardhshme. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Parapagime të Arkëtuara	240,350,238	296,385,470
Total	240,350,238	296,385,470

16. Huamarrje te tjera afatgjata

Paraqet pjesën afatgjate te huamarrjeve qe ka realizuar dega ne Kosove. Perberja analitke e tij paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Kredi dhe Huatë, pjesa afatgjatë	-	4,576,900
Detyrime të tjera afatgjata	-	1,840,629
Total	-	6,417,529

17. Provizionet Afatgjata

Në këtë zë paraqitet shuma e provizioneve të vlerësuara nga shoqëria e cila vjen e pandryshuar që nga periudhat paraardhëse.

18. Kapitale të veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2021, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Kapitali i paguar	40,196,760	40,199,700
Rezerva ligjore	1,577,454	1,577,454
Rezerva te tjera	297,775,030	139,433,530
Fitimi (Humbja) i/e vitit të kaluar	38,531,581	41,977,784
Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar	100,762,655	160,109,031
Total	478,843,480	383,297,500

19. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës. Shoqëria realizon të ardhurat nga aktiviteti i saj që është ndërtimi dhe rikonstruksioni i objekteve të ndryshëm, kërkime dhe gërmime arkeologjike etj. Ky zë paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Shitje e punimeve dhe e shërbimeve	1,203,067,847	682,530,612
Total	1,203,067,847	682,530,612

Të ardhurat e realizuara nga dega në Kosovë janë 56,028,299 lekë.

20. Të ardhura të tjera

Në këtë zë paraqiten të ardhura të tjera që realizon shoqëria mëmë që nuk janë pjesë e aktivitetit kryesor. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Të ardhura të tjera - Qira	2,016,000	2,005,333
Të ardhura të tjera	26,400	971,613
Total	2,042,400	2,976,946

20.1 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Paraqet ndryshimin në produktet e gatshme të shoqërisë mëmë, apartamentet, për shitjet e vitit 2021.

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Gjendje në fillim produkti i gatshëm	-272,065,841	-303,765,986
Gjendje në fund produkti i gatshëm	257,439,373	272,065,841
Total	-14,626,468	-31,700,146

21. Materiale të konsumuara (KMSH)

Në këtë zë përfshihen kostoja e materialeve të përdorura, nënkontraktimet e punimeve për pjesë të veçanta të projekteve etj. për ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit ushtrimor. Siç u përmend edhe në shënimin 3.5, shoqëria përdor inventarizim periodik. Përmbajtja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Shpenzime materiale, shërbimesh, nënkontraktime punimesh	967,767,657	357,058,124
Total	967,767,657	357,058,124

Kosto e materialeve e degës në Kosoëvë që përfshihet në këtë zë është 38,122 mijë lekë.

22. Shpenzime personeli

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2021. Gjatë kësaj periudhe raportuese shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit në Shqipëri dhe në Kosovë. Përbërja e shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Shpenzime për paga	59,241,923	54,102,943
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore	9,701,842	8,741,538
Total	68,943,765	62,844,481

“AD - STAR” sh.p.k

PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË

31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUEHET

22. Shpenzime personeli - vazhdim

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetsore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve (Kosova 45 mijë lekë). Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetsore.

23. Shpenzimet e tjera

Përbërja e këtij zëri të shpenzimeve paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31-Dhjetor-21	31-Dhjetor-20
Shpenzime komisione bankare	5,141,707.60	2,884,197.25
Shpenzime konsulence nga të tretët dhe të tjera profesionale	4,023,973.54	36,981,505.23
Shpenzime udhëtimi, dieta	220,000.00	629,333.33
Shpenzime telefoni, internet, dhe të ngjashme	128,905.71	335,107.54
Shpenzime për taksat	1,701,571.80	1,025,905.50
Shpenzime për sigurime	3,306,554.81	2,411,038.30
Shpenzime për mirëmbajtjen e zyrave	894,110.26	739,289.52
Gjoha dhe dëmtshpërblime	796,447.84	691,553.57
Materiale zyre, kancelari	261,360.56	265,624.33
Qira	863,929.02	1,039,962.56
Shpenzime të tjera personelin, pritje përcjellje	29,941.67	23,583.33
Të tjera	1,373,934.94	1,587,349.66
Diferenca kursi këmbimi furnitore, klientë dhe të tretët të tjere	9,879,462.32	-503,848.38
Total	28,621,900	48,110,602

Shpenzimet e konsulencës dhe nga të tretët paraqesin kostot e shërbimeve nga të tretët, konsulencë, kërkime e studime, nënkontraktime për punë të ndryshme etj. Në zërin e qirave janë përfshirë dhe shpenzimet e qirasë të degës për 499,065 lekë.

Shpenzimet e tjera, paraqesin pagesat për blerje të ndryshme të tjera, etj.

24. Të ardhurat dhe shpenzime për interesa

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
Të Ardhura nga Interesi	3,410	3,469
Shpenzime nga Interesi	-764,818	-50,729
Total	-761,408	-47,260

25. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve të shprehura në monedhë të huaj.

Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

Përshkrimi	31 Dhjetor 21	31 Dhjetor 20
<i>Fitimi nga Kurset e këmbimit</i>		
Fitime nga azhornimi i Arkës/Bankës dhe të tretëve	2,616,242	6,068,765
<i>Humbje nga Kurset e këmbimit</i>		
Humbje nga azhornimi i Arkës/Bankës dhe të tretëve	-5,706,036	-639,067
Total	-3,089,795	5,429,698

“AD - STAR” sh.p.k

PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIU DHËN USHTRIMORE QË PËRFUNDOI MË

31 DHJETOR 2021 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKË, PËRNDRYSHË SHKRUHET

26. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël të konsoliduar prej 118,860 mijë lekë (dega një humbje prej 984 mijë lekë). Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2021 në Shqipëri shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qëllime fiskale një sërë shpenzimesh. Fitimi i tatueshëm i shoqërisë për vitin 2021 rezulton 120,650 mijë lekë. Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2021 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e rezultatit tatimor 2021	Viti 2021	Viti 2020
Fitimi/Humbja e vitit 2021	119,844,332	188,512,021
Korigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:	805,692	840,381
Shpenzime me dok jo të rregullta	805,692	840,381
<i>Shpenzime të tjera</i>	<i>9,245</i>	
<i>Gjoha Penalitete e të ngjashme</i>	<i>796,448</i>	
Totali i shpenzimeve të panjohura	805,692	840,381
Fitimi/Humbja i tatueshëm para mbartjes së humbjes fiskale	120,650,024	189,352,403
Humbja fiskale nga viti		
Fitimi/Humbja fiskale e vitit 2021	120,650,024	189,352,403
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	15%	15%
Tatimi aktual mbi fitimin 2021	18,097,024	28,402,860
Tatim fitimi i vitit 2021 - paguar në Kosovë	-	-196,401
Shpenzimi kontabël i tatimit mbi fitimin	18,097,504	28,206,459

Dega në Kosova për vitin 2021 ka realiuar një humbje të barabart me 984,173 mijë lekë, vlerë e cila nuk është përfshirë në uljen e fitimit fiskal të shoqërisë mëmë e për rrjedhojë nuk është marrë në konsideratë në uljen e shpenzimit të tatim fitimit të realizuar nga shoqëria mëmë në Shqipëri.

Shoqëria përdor norma amortizimi sa normat tatimore (referoju shënimit 3.5 (ii)) dhe nuk ka llogaritur tatim fitim te shtyrë.

27. Ngjarjet pas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

